



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHëndETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



United Nations
ALBANIA



TË RINJTË

Bashkia e Korçës



Shtator 2018



Leave
No One
Behind



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

Ky Publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në kuadër të projektit: "Leave No One Behind". (Askush të mos Mbetet Pas), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensitë të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Përmbajtja e këtij Publikimi është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të rinjve". Opinione të shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së.

Në periudhën Korrik - Gusht 2018 janë anketuar 100 të rinj nga Bashkia e Korçës me qëllim matjen e njohurive të tyre mbi:

- a. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals - SDGs)
- b. Shëndetin Seksual dhe Riprodhues
- c. Programet dhe shërbimet e Bashkisë për të rinjtë

PROFILI I TË RINJVE TË ANKETUAR:

- Grupmosha: 15 - 29 vjeç
- Vendndodhja:

61% nga zonat urbane

- Shkolla "Raqi Qirinxhi"
- Universiteti "Fan. S. Noli"
- Lagja 1,2,4,8, 9,10,12,15,17

39% nga zonat rurale

- Pojan
- Maliq
- Voskopojë
- Bulgarec

■ Djem ■ Vajza



55 përqind
e të rinjve të anketuar janë vajza

FAKTE MBI TË RINJTË E KORÇËS

A. NJOHURITË MBI OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT
TË QËNDRUESHËM (SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS - SDGs)



Afërsisht 1 në 12
të rinj kanë dëgjuar se çfarë janë SDGs

- a. Organizatat jofitimprurëse (33%) janë burimi më i shpeshtë i informacionit për të rinjtë në zonat urbane për pasurimin e njohurive të tyre mbi këtë çështje.
- b. Shkolla (25%) dhe Interneti (25%) janë gjithashtu burimi i rëndësishëm informacioni për të rinjtë në zonat urbane.
- c. Të gjithë të rinjtë e anketuar në zonat rurale janë shprehur se nuk kanë dëgjuar më parë për SDGs.

Ndërsa *institucionet* lokale në asnjë rast nuk janë cituar si burim informacioni mbi SDGs nga të rinjtë e anketuar në zonat urbane dhe rurale.

A bar chart comparing the percentage of respondents for different sources of information between two groups: Qytet (Urban) and Fshat (Rural). The Y-axis represents the percentage from 0% to 35% in 5% increments. The X-axis lists six sources of information: Familja, Shkolla, Interneti, Institucionet lokale, OJF, and an unlabeled category. For the Qytet group, the percentages are: Familja (17%), Shkolla (25%), Interneti (25%), Institucionet lokale (0%), OJF (33%), and the unlabeled category (0%). For the Fshat group, all sources show 0%.

Grupi	Familja	Shkolla	Interneti	Institucionet lokale	OJF	Qytet (Total)
Qytet	17%	25%	25%	0%	33%	100%
Fshat	0%	0%	0%	0%	0%	0%

ANGAZHIMI I TË RINJVE NË ARRITJEN E SDGs

A. NJOHURITË MBI OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS - SDGs)


Të rinjtë janë pyetur në lidhje me angazhimin personal dhe përfshirjen në aktivitete të ndryshme mbi SDGs.

Shumica e të rinjve të grupmoshave të ndryshme (61% e rasteve) janë shprehur se **nuk janë përfshirë personalisht në arritjen e SDGs.**

Vetëm 13 % e të rinjve të grupmoshës 24 - 29 vjeç shprehen se janë përfshirë pjesërisht për arritjen e SDGs.

Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (26% e grupmoshave të ndryshme) shprehen se dëshirojnë të përfshihen, por nuk kanë informacionin e nevojshëm se si mund të ndodhë kjo gjë.

Përqindja e të rinjve të përfshirë personalisht në arritjen e SDGs



Të rinjtë janë pyetur edhe mbi rolin që ata mendojnë se mund të kenë për arritjen e SDGs.



Roli i të rinjve në arritjen e SDGs (sipas të rinjve të anketuar)

- Pjesëmarrja dhe përfshirja direkte e të rinjve të komuniteteve të ndryshme në çështjet me interes të lartë për ta.
- Aktivitete informuese, ndërgjegjësuese në shkolla dhe institucione të ndryshme me të rinjtë.
- Aktivitete lobuese dhe advokuese për përfshirjen e çështjeve prioritare për të rinjtë në axhendat kombëtare dhe lokale.

FAKTE MBI TË RINJTË E KORÇËS


B. NJOHURITË MBI SHËNDETIN SEKSUAL DHE RIPRODHUES

Të rinjtë janë pyetur edhe mbi njohuritë e tyre në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues.

Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. Anketimi tregoi se **vetëm 1%** e të rinjve nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.


100% e të rinjve të anketuar në zonat urbane janë shprehur se kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. Vetëm një djalë 22 vjeç (5% e meshkujve të anketuar) nga zonat rurale ka pohuar se nuk ka marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.

Përqindja e të rinjve të anketuar që kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues




Ndërmjet të rinjve që kanë njohuri mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, **shkolla dhe shokët/shoqet janë burimi më i shpeshtë i informacionit të përdorur** për pasurimin e njohurive të të rinjve mbi këtë çështje.

Ndërsa **shkolla dhe trajnimet konsiderohen mjetet ideale për marrjen e informacionit** për shëndetin seksual dhe riprodhues nga ana e të rinjve.



Përqindja e të rinjve anketuar që kanë marrë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues




Shumica e të rinjve (64%) shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është pjesërisht i mjaftueshëm.

Interesante është rezultati mbi 6% e të rinjve në zonat urbane që shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është i mjaftueshëm, përkundëjt 1% e të rinjve në zonat rurale.

Nga analiza gjinore rezulton se shumica e të anketuarve që janë përgjigjur se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues nuk është i mjaftueshëm, janë djem.

A është i mjaftueshëm informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues?




Nga anketimi i të rinjve në Korçë rezultoi se një pjesë prej tyre (8% në zonat rurale dhe 3% në zonat urbane) nuk flasin me prindërit e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar (62% në zonat rurale dhe 10% në zonat urbane) shprehen se nuk mund të flasin me prindërit e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe se më e lehtë për ta është të komunikojnë me shokët/shoqet (38% në zonat urbane dhe 21% në zonat rurale).

Në radhët e të rinjve që flasin mbi këtë tematikë rezultoi se asnjë prej të rinjve në zonat urbane dhe rurale nuk komunikoi për këtë me babain, ndërsa 23% e të rinjve në zonat urbane dhe 5% e të rinjve në zonat rurale preferojnë të komunikojnë vetëm me nënën.

Interesante është rezultati i 3% i të rinjve në zonat rurale që shprehen se prindërit nuk i lejojnë të komunikojnë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues në familjet e tyre. Kjo gjë është komunikuar nga vajzat e anketuara dhe sjell në vëmendje nevojën për ta adresuar këtë tematikë me prindërit.

A është i mjaftueshëm informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues?




FAKTE MBI TË RINJTË E KORÇËS

C. NJOHURITË MBI PROGRAMET DHE SHËRBIMET E BASHKISË PËR TË RINJTË


Nga anketimi i kryer rezultojnë se pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar nuk kanë njohuri mbi programet dhe shërbimet që Bashkia ofron për të rinjtë. Vetëm 1 në 12 të rinj janë në dijeni të programeve/prioriteteve të Bashkisë në lidhje me të rinjtë. Nga anketimi rezultojnë se vajzat nga zonat urbane janë më në dijeni për programet dhe prioritetet e Bashkisë për të rinjtë (11% e vajzave të anketuara). Ndërsa më pak të informuar mbi programet që ofron Bashkia për të rinjtë janë vajzat dhe djemtë në zonat rurale (5% e vajzave dhe 5% e djemve që janë anketuar janë shprehur se kanë dijeni për këto programe).

Përqindja e të rinjve të cilët kanë dijeni për programet prioritetet e Bashkisë në lidhje me të rinjtë, sipas gjinisë dhe zonave



Shumica e të rinjve (97% në zonat rurale dhe 80% në zonat urbane) shprehen se nuk kanë marrë ndonjëherë pjesë në takime që Bashkia ka zhvilluar me të rinjtë për përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit të zonës, si dhe nuk janë në dijeni të këtyre takimeve.

**Përqindja e të rinjve që kanë marrë pjesë në takime që
Bashkia ka zhvilluar me të rinjtë për përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit të zonës**



Vetëm 11% e të rinjve në zonat urbane shprehen se kanë marrë pjesë ndonjëherë në këto takime, shumica e të cilëve janë vajza.


Nga të rinjtë që janë informuar mbi programet e Bashkisë rezulton se mjetet më të përdorur për marrjen e informacionit nga Bashkia janë:

a. Zyrat e administratës (33%) - për të rinjtë në zonat rurale

b. Faqja zyrtare e Bashkisë (28%) - për të rinjtë në zonat urbane


Njoftimet publike dhe broshurat mbeten gjithashtu mjete informuese të përdorura nga të rinjtë. Ndërkohë që faqja zyrtare e Bashkisë është një ndër mjetet më të përdorura nga të rinjtë në zonat urbane, nuk rezulton një gjë e tillë me të rinjtë në zonat rurale.

Përqindja e të rinjve që kanë përdorur format e mëposhtme për marrjen e informacionit nga Bashkia




Aktivitetet informuese, ndërgjegjësuere dhe argëtuese, takimet e vazhdueshme informuese dhe trajnimet janë programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia e Korçës. Gjithashtu të rinjtë kanë identifikuar si shërbime të preferuara edhe ofrimin e ambjenteve sportive, punësimit, qendrën rinore, e-shërbimet (online) si edhe ofrimin e bursave.

Përqindja e të rinjve që do të donin që Bashkia të ofronte shërbimet e mëposhtme për të rinjtë



Një pjesë shumë e ulët e të rinjve (2 %) vlerësojnë shumë mirë ofrimin e shërbimeve administrative të Bashkisë në përputhje me nevojat e të rinjve, ndërsa 2% e të rinjve vlerësojnë maksimalisht ngritjen dhe funksionimin e zyrave me një ndalesë në Bashki.

Përqindja e të rinjve të cilët vlerësojnë me pikët më poshtë shërbimet që janë ofruar nga Bashkia për të rinjtë (1- vlera më e vogël, 5 - vlera më e madhe)



TË RINJTË

Bashkia e Korçës



Shtator 2018